



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 1650 akti

V E N D I M
“Vendosje sekuestro preventive”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga :

GJYQTARE : IBRAHIM HOXHA

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Asije Velçani**, sot më dt. **04.12. 2012**, mori në shqyrtim kërkesën penale që i përket :

KERKUES : Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori **Ardian Braho**.

OBJEKTI : Vendosje sekuestro preventive

BAZA LIGJORE : Neni 274 parag 1 dhe 2 të K.Pr.Penale

Gjykata pasi administroi provat shkresore të kërkesës penale, dëgjoji pretendimet përfundimtare të prokurorit i cili kërkoi: *pranimin e kërkesës*, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor,

V Ë R E N

Në date 11.05.2012, Prokuroria e rrethit gjyqësor, Tirane ka regjistruar procedimin penal nr.2275 qe ben fjale per vepren penale te **“Pastrimit te produkteve te vepres penale”**, veper penale e parashikuar nga neni 287 i K.Penal ne ngarkim te personit nen hetim (.....).

Nga kryerja e veprimeve hetimore që ka kryer organi i akuzës ka rezultuar se në date 25.01.2009 ne piken e kalimit kufitar Kakavije te rrethit Gjirokaster gjate kontrollit te ushtruar nga sherbimet e policise ne automjetin autobus te shoqerise te transportit te udhetareve **“Klid-Ballkan”** sh.p.k me targa (.....) eshte sekuestruar nje sasi prej 12 (dymbedhete) pako me peshe prej 1

(nje) kilogram secila te cilat ishin me bime narkotike te llojit Cannabis Sattiva. Ne lidhje me sasine e bimes narkotike eshte bere arrestimi ne flagrance dhe me pas eshte gjykuar ne Gjykatën e shkalles se pare per Krime te Renda, Tirane shtetasi (.....). Ne perfundim te gjykimit Gjykata e shkalles se pare per Krime te Renda me vendimin nr.34, date 12.06.2009 ka deklaruar fajtor shtetasin (.....) per vepren penale te **“Trafikimit te lendeve narkotike”**, veper penale e parashikuar nga neni 283/a te K.Penal.

Nga kryerja e veprimeve hetimore ka rezultuar se shtetasi (.....) ka ndryshuar ne kohe gjeneralitet. Keshtu, me vendimin nr.2229, date 07.06.2003 te Njesise Bashkiake nr.4, Tirane ky shtetas qe ka pasur mbiemrin “(.....)” e ka ndryshuar ne “(.....)”, ndersa me date 01.08.2003 me vendimin nr.2183 te Njesise Bashkiake nr.4, Tirane ky shtetas qe ka pasur emrin “(.....)” e ka ndryshuar ne “(.....)”.

Në date 21.09.2011 shtetasi (.....) ka ndryshuar perseri gjeneralitet ne (.....) i biri i (.....) dhe i (.....), i datelindjes 12.08.1968, lindur dhe banues ne Tirane.

Nga kryerja e veprimeve hetimore ka rezultuar se shtetasi nen hetim (.....) eshte pronar i nje godine 3 (tre) kateshe me vendndodhje ne rrugen “(.....)” ne qytetin e Tiranës me siperfaqe trualli prej 300 metra katrore, me siperfaqe ndertimi prej 277 metra katrore. Ky ambient figuron i regjistruar ne Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluejtshme, Tirane me emrin “.....” ne zonen kadastrale nr.(.....) me numer pasurie (.....), volumi 41, faqja nr.152. Regjistrimi i kesaj pasurie ka ardhur nga procesi i legalizmit ku kjo godine eshte pajisur me leje legalizimi nr.(.....), date 07.07.2011 nga Drejtoria Rajonale Aluizni-t, Tirane, leje e cila ka dale ne emer te personit nen hetim (.....).

Nga ana e organit të akuzës eshte autorizuar vezhgimi ambiental i godines te sipercituar si dhe levizjeve te personit nen hetim (.....). Nga kryerja e ketij veprimi hetimor eshte identifikuar nga jashte, pasi objekti eshte i rrethuar me mur, fakti qe ambientet e godines te sipercituar jane pershtatur per hoteleri ku godina mban emrin “(.....)”. Nga vezhgimi i levizjeve te personit nen hetim (.....) ky i fundit eshte pare duke hyre e dale brenda oborrit te godines si dhe ne krah te hotelit eshte parkuar edhe mjeti i tipit *“Benz”* me ngyre te zeze me targa (.....) ne pronesi te shtetasit (.....).

Nga pergjigjja e ardhur nga Qendra Kombetare e Regjistrimit ka rezultuar se personi nen hetim (.....) eshte i regjistruar si person fizik per ushtrimin e aktivitetit ekonomik ne fushen *“Hoteleri”*.

Nga kryerja e veprimeve hetimore ka rezultuar se personi nen hetim (.....) nuk ushtron aktivitete te tjera ekonomike apo tregtare si dhe nuk ka te ardhura te tjera perjashtuar aktivitetin sa me siper.

Nga pergjigjja e ardhur nga banka "Raiffeisen Bank" ka rezultuar se personi nen hetim (.....) eshte klient i kesaj banke me nje llogari bankare e celur ne date 18.05.2012 ne nje shume prej (.....) leke te cilat jane derdhur nga nje tranferte e bere nga subjekti "Tirona".

Nisur nga te dhenat e mesiperme organi i akuzës pretendon se janë përpara kushteve te parashikuara nga neni 274 te K.Pr.Penale qe ka te beje me aplikimin e sekuestros preventive pasi:

- Shtetasi nen hetim (.....) eshte person i cili po hetohet per vepren penale te "**Pastrimit te produkteve te vepres penale**", vepren penale e parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Keshtu personi nen hetim (.....) eshte hetuar, gjykuar dhe denuar per vepren penale te "**Trafikimit te lendeve narkotike**", vepren penale e parashikuar nga neni 283/a te K.Penal. Vepra penale e parashikuar nga neni 283/a e K.Penal futet ne kategorine e pjeses dermuese te veprave penale te parashikuara ne K.Penal e cila ka si motiv te kryerjes perftimin material. Shtetasi nen hetim (.....) po hetohet, pra dyshohet, qe produktet e veprimtarise kriminale i ka perdorur dhe investuar ne veprimtari ekonomike ne fushen e hotelerise.

- Shtetasi nen hetim (.....) eshte pronar i godines qe perben "(.....)" nisur nga provat qe permenda me lart. Pra personi nen hetim eshte i lidhur me pronen sa me siper.

- Disponimi i lire i pasurise te mesiperme nga ana e shtetasit nen hetim (.....) po sjell si pasoje shtimin dhe zgjatjen e pasojes se vepres penale per te cilen eshte denuar tashme shtetasi nen hetim, vepren penale te parashikuar nga neni 283/a te K.Penal. Gjithashtu ekziston rreziku, nisur nga rrezikshmeria e personit nen hetim si dhe e vepres penale per te cilen ai eshte denuar, qe te ardhurat e kesaj pasurie te perdoren per aktivite kriminale te njejta apo te tjera.

- Pasuria e mesiperme, e dyshuar si produkt i veprimtarise kriminale te trafikimit te lendeve narkotike, eshte objekt i konfiskimit te mevonshem sipas nenit 36 te K.Penal e për rrjedhoj kërkon:

1. *Vendosjen e sekuestros preventive te pasurise godine 3 (tre)-kateshe e cila mban emrin "(.....)" me vendndodhje ne rrugen "(.....)" ne qytetin e Tiranës me sipërfaqe trualli prej 300 metra katrore, me sipërfaqe ndertimi prej 277 metra katrore, regjistruar ne Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluejtshme, Tirane ne zonen kadastrale nr.(.....) me numer pasurie (.....), volumi 41, faqja nr.152. Kjo pasuri eshte regjistruar mbi bazen e Lejes se Legalizimit nr.(.....), date 07.07.2011 te Drejtorise Rajonale te Aluizni-t, Tirane ne emer te shtetasit (.....).*

2. *Per ekzekutimin e mases se sekuestros te ngarkohen oficeret e policise gjyqesore te Seksionit Kunder Pastrimit te Parave ne Drejtorine e Policise se Qarkut, Tirane.*

Gjykata çmon se kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet pranuar për arsye se :

Në nenin 274 të K.Pr.Penale të emërtuar “Objekti i sekuestros preventive”, në pikat 1 dhe 2 të kësaj dispozite parashikohet shprehimisht se :

“1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të K.Penal

Gjykata që ka dhënë vendimin mund të veprojë vetë ose të urdhërojë që veprimi të kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore të caktuar në vendimin e kontrollit ..”

Në rastin konkret ekzistojnë arsye të bazuara për të menduar se në rastin konkret ekziston dyshimi i arsyeshëm që personi nën hetim (.....) të ketë konsumuar veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, vepër penale kjo e parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Për rrjedhojë gjykata çmon se ekzistojnë kushtet për vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurinë e mësipërme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në zbatim të nenit 274 pikat 1 dhe 2 të K.Pr.Penale

VENDOSI

-Pranimin e kërkesës.

1. Vendosjen e sekuestros preventive te pasurise godine 3 (tre)- kateshe e cila mban emrin ”(.....)” me vendndodhje ne rrugen ”(.....)” ne qytetin e Tiranës me siperfaqe trualli prej 300 metra katrore, me siperfaqe ndertimi prej 277 metra katrore, regjistruar ne Zyren Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluejtshme, Tirane ne zonen kadastrale nr.(.....) me numer pasurie (.....), volumi 41, faqja nr.152. Kjo pasuri eshte regjistruar mbi bazen e Lejes se Legalizimit nr.7155, date 07.07.2011 te Drejtorise Rajonale te Aluizni-t, Tirane ne emer te shtetasit (.....).

2. Per ekzekutimin e mases se sekuestros te ngarkohen oficeret e policise gjyqesore te Seksionit Kunder Pastrimit te Parave ne Drejtorine e Policise se Qarkut, Tirane.

3. Per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohen O.P.GJ te Drejtorise Kunder Krimit Financiar ne Departamentin per Hetimin e Krimeve ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise se Shtetit.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë nga cilido që ka interes brenda 10 ditëve nga dita e dhënies së vendimit, ose brenda 10 ditëve nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.

U shpall sot në Tiranë më datë 04.12. 2012.

SEKRETARE
Asije VELÇANI

GJYQTAR
Ibrahim HOXHA